

20150441611

L I G J PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR VEPRIMTARI TË INOVACIONIT

Neni 1

Në Ligjin për veprimtari të inovacionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 79/13, 137/13 dhe 41/14) në nenin 25 në paragrafin 1 pas alinesë 3 shtohet aline e re 4, si vijon:

" - grante të kofinancuara për vendosjen, punën dhe investimet e akseleratorëve teknologjikë-afaristë,"

Pas paragrafit 2 shtohen 17 paragrafë të rinj 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19 si vijojnë:

"Gjatë evaluimit dhe vendimmarrjes për projektet e paraqitura në konkursin publik nga paragrafi 2 të këtij neni, Fondi mund të angazhojë persona profesionalë nga Regjistri i personave profesionalë nga sfera adekuate nga paragrafi 9 i këtij neni që të bëjnë evaluim dhe të japin mendim profesional.

Personi profesional nga paragrafi 3 i këtij neni është i obliguar që ta shqyrtojë materialin dhe të dorëzojë evaluim dhe mendim profesional në afat prej shtatë ditëve të punës nga dita e marrjes së materialit.

Në shtojcë të mendimit të tij, personi profesional dorëzon deklaratë me përgjegjësi të plotë materiale, morale dhe penale se mendimi është përpiluar në mënyrë të ndërgjegjshme dhe profesionale, në pajtim me rregullat e shkencës dhe profesionit, normave etike dhe standardeve profesionale dhe se nuk do të marrë pjesë në mënyrë direkte ose indirekte në procedurën e ndarjes së marrëveshjes për grant që është lëndë e kërkesës për evaluim.

Personat profesionalë kanë të drejtë për kompensim të evaluimit të bërë dhe mendimit të dhënë profesional që është në ngarkim të Fondit në shumë që përcaktohet me tarifë që e miraton Këshilli drejtues i Fondit, me pëlqim paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Lartësia e kompensimit nga paragrafi 6 i këtij neni përcaktohet sipas llojit të procedurës, vlerës së përcaktuar të marrëveshjes dhe kompleksitetit të saj si dhe kohës së nevojshme për mbledhjen e të dhënave dhe përpunimit të evaluimit dhe mendimit.

Mënyra e kyçjes dhe puna e personave profesionalë në punën e Fondit gjatë evaluimit dhe dhënies së mendimit profesional rregullohet me rregullore të cilën e miraton Këshilli drejtues i Fondit.

Fondi vendos dhe udhëheq Regjistër elektronik të personave profesionalë që i ndihmojnë gjatë evaluimit dhe dhënies së mendimit profesional, të dhënat personale të personave profesionalë që do të evidentohen në Regjistrin e personave profesionalë janë: emri dhe mbiemri, data dhe vendi i lindjes, shtetësia, adresa e jetesës, telefoni për kontakt, adresa elektronike, sfera e specializimit, të dhëna për arsimin e kryer, përvoja e punës dhe arsimimi joformal. Afati për ruajtjen e të dhënave personale është tre vite, duke llogaritur nga dita e njoftimit për shlyerje nga Regjistri i personave profesionalë.

Për regjistrim në Regjistrin e personave profesionalë, fondi publikon ftesë publike në të cilën konstatohen sferat e specializimit, kushtet e zgjedhjes, mënyra e parashtrimit të fletëparaqitjeve, dokumentacioni i nevojshëm për dëshmimin e plotësimit të kushteve për zgjedhje dhe elemente tjera që i përcakton Këshilli drejtues i Fondit.

Regjistrimi në Regjistrin e personave profesionalë bëhet në bazë të kërkesës së parashtruar me shkrim të cilës i bashkëngjiten edhe prova për plotësimin e kushteve të përcaktuara në paragrafin 12 të këtij neni.

Që të regjistrohet në Regjistrin e personave profesionalë, personi duhet t'i plotësojë këto kushte:

- të ketë së paku arsimin e lartë nga sfera adekuate;

- ta njohë gjuhën angleze;
- të ketë marrë pjesë në së paku dy projekte të sferës adekuate në katër vitet e fundit;
- me vendim të plotfuqishëm të mos i jetë shqiptuar ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës përderisa zgjasin pasojat e ndalimit dhe
 - të ketë së paku shtatë vite përvojë punë në sferën adekuate për të cilën është parashtruar kërkesa.

Përvoja ndërkombëtare në sferën e specializimit dhe përvoja në zbatimin e analizës thelbësore do të llogaritet si përparësi gjatë regjistrimit në Regjistrin e personave profesionalë.

Drejtori i Fondit formon Komisioni për zgjedhjen e personave profesional dhe miraton vendim për zgjedhjen dhe regjistrimin e personave profesionalë në Regjistër.

Para lidhjes së marrëveshjes me personat zyrtar dhe regjistrimin e tyre në Regjistrin e personave profesional, Komisioni për zgjedhjen e personave profesional mund të zbatohet kontroll shtesë dhe intervista me kandidatët e paraqitur.

Personat profesionalë shënohen në Regjistrin e personave profesionalë sipas sferave të specializimit që i përcakton Këshilli drejtues i Fondit. Një person mund të regjistrohet në Regjistrin e personave profesionalë në më shumë sfera të specializimit për të cilat ka parashtruar kërkesë dhe i plotëson kushtet nga paragrafi 12 i këtij neni.

Fondi do ta fshijë personin nga Regjistri i personave profesionalë nëse:

- atë vetë e kërkon,
- jep mendim joprofesional, respektivisht të njëjtin e përpilon në kundërshtim me rregullat e shkencës dhe profesionit, standardeve profesionale dhe rregullave për pengimin e konfliktit të interesave,
- personi nuk dorëzon mendim pas materialeve të marra në afatin nga paragrafi 4 i këtij neni ose
- për shkak të vdekjes së personit.

Personi që është fshirë nga Regjistri nuk ka të drejtë të regjistrohet sërish në të njëjtin.

Mënyra e udhëheqjes së Regjistrit të shënimit dhe fshirjes së personave profesionalë përcaktohet me rregullore që e miraton Këshilli Drejtues i Fondit."

Paragrafët 3 dhe 4 bëhen paragrafë 20 dhe 21.

Neni 2

Në nenin 31 në paragrafin 1 pas fjalisë së parë shtohet fjali e dytë si vijon: "Nga radhët e anëtarëve, Qeveria përcakton kryetarin e Komitetit për miratimin e investimeve."

Në paragrafin 6 pas fjalisë së parë shtohet fjali e dytë si vijon: "Kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për miratimin e investimeve u paguhen edhe mjete për shpenzimet e bëra rrugore (bileta aeroplani ose bileta për lloj tjetër të transportit, transporti prej dhe deri te aeroporti në shtet), shpenzime për vendosje dhe ushqim gjatë kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në shtet."

Pas paragrafit 6 shtohet paragraf i ri 7 si vijon:

"Shpenzimet për vendosje dhe ushqim gjatë kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në shtet i përcakton Këshilli drejtues i Fondit."

Paragrafët 7, 8, 9 dhe 10 bëhen paragrafë 8, 9, 10 dhe 11.

Neni 3

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për veprimtari të inovacionit.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".